



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 1, datë 06.02.2024

**PËR**

**MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË, QË DO TË TRAJTOHEN  
ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR  
BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO, QË DO TË TRAJTOHEN ME  
FONDE TË BUXHETIT VENDOR**

Në mbështetje të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 ‘Për vetëqeverisjen vendore’ i ndryshuar; Ligjit nr. 57/2019, datë 18.07.2019 ‘Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë’; VKM nr. 955, datë 07.12.2016 ‘Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike’ i ndryshuar; Udhëzimeve nr.3, nr.4, nr.5, datë 17.02.2017 ‘Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 %’, i ndryshuar, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; VKB-së nr.195, datë 22.12.2023 ‘Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2024’ si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6 % të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, si më poshtë vijon:

Përfitues të këtij fondi do të jenë :

- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:
  - Familja përpara se të përzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond duhet të jetë verifikuar paraprakisht nga administratori shoqëror.
  - Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
  - Familjet me kryefamiljare gra, të veja, të divorcuara, me të paktën një fëmijë, që ndjekin arsimin bazë ose të lartë.
  - Familje me kryefamiljare vajza nënë dhe me fëmijë nën 16 vjeç.
  - Të moshuar të vetmuar.
  - Rastet kur kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.
2. Miratimin e kritereve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fonde të pushtetit vendor.

Përfitues të këtij fondi do të jenë:

- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
- Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jenë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
- Rastet kur kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.
- Familjet me kryefamiljare gra, (të veja, të divorcuara), me të paktën një fëmijë, që ndjekin arsimin bazë ose të lartë.
- Familjet të cilat kanë fëmijë në moshë madhore, por që kanë probleme të ndryshme sociale (përdorues të lëndëve narkotike, probleme me ligjin, etj), të cilët kanë vështirësi punësimi.



- Familjet rome, të cilat kanë problem me regjistrimin dhe transferimin.
  - Familjet me një anëtar, që nuk kanë të ardhura ose i kanë të pamjaftushme.
  - Familjet me kryefamiljare gra, të cilat kanë të paktën një fëmijë, që ndjekin arsimin bazë ose të lartë dhe ju ka përfunduar urdhëri i mbrojtjes.
3. Masa e ndihmës ekonomike për çdo familje do të përlogaritet sipas Udhëzimit nr.4, datë 17.02.2017 “Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimit Drejtoria e Shërbimit Social.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 07.02.2024**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 97 / Prot.

Durrës, më 15 02 .2024

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.1 datë 06.02.2024 “Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe për ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

